Nuk ka namaz kur shtrohet ushqimi e as nën presionin e nevojave fiziologjike

Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut duke thënë: "Nuk ka namaz kur shtrohet ushqimi e as nën presionin e nevojave fiziologjike."

[Sahih] [Transmeton Muslimi]

I Dërguari i Allahut në këtë hadith e ka ndaluar faljen e namazit kur shtrohet ushqimi, tek i cili shpirti i namazliut anon dhe zemra e tij është e lidhur me të. Gjithashtu, e ndaloi të falet namazi nën presionin e nevojave fiziologjike: nevojës së vogël dhe të madhe, për shkak se mendja e tij angazhohet për ta larguar këtë presion.

http://www.sunnah.global/hadeeth/sq/show/3088